



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:148205

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05432282

Ac.nr.332/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi- kryetar i kolegjit, Besnik Bislimaj dhe Rafet Haxhaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit - propozuesit të sigurimit: Zh. R. nga L., të cilin e përfaqëson S.K., avokat në L., sipas autorizimit, kundër të paditurve - kundërshtarëve të sigurimit: Z. M. nga S., Republika e Serbisë dhe M. R. nga L., të cilin me autorizim e përfaqëson avokati N. G., për lirim nga pagesa e garancionit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, CN.nr.90/2023, të datës 31.07.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditësit Zh. R. nga L., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës së Apelit e Kosovës CN.nr.90/2023, i datës 31.01.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e Apelit me Aktvendimin e ankimuar CN.nr.90/2023 të datës 31.07.2023 ka hedhur si të palejuar propozimin e propozuesit për përsëritje të procedurës.

Kundër këtij Aktvendimit CN.nr.90/2023, ankesë ka paraqitur paditësi-propozuesi, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim si në të njejtën.

I padituri ka paraqitur përgjigje në ankesë, me propozim si në të njejtën.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë tani në përbërje prej tre gjytarëve bazuar në nenin 240.4 të LPK-ës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e propozuesit-paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se propozuesi me datë 15.07.2022 ka parashtruar propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, ndaj kundërpropozuesve.

Me Aktvendimin C.nr.674/22 të datës 22.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega bë Lipjan propozimi i propozuesit është provuar dhe është caktuar masa e përkoshme e sigurimit.

Të paditurit ka kundërshtuar masën e përkohshme të sigurimit, ndërsa gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës nxjerrë Aktvendimin C.nr.674/22 të datës 17.10.2022, me anë të së cilit detyrohet paditësi që në afat prej 3 ditësh të deponoj në arkën e gjykatës 3,000.00 Euro, në emër të garancionit për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë.

Paditësi përmes parashtrësës së datës 19.10.2022, ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë lirim nga garancioni, ndërsa gjykata e shkallës së parë duke vendosur lidhur me këtë kërkesë ka nxjerrë Aktvendimin C.nr.674/22 të datës 20.10.2022 dhe ka refuzuar kërkesën e paditësit për lirim nga garancioni. Këndër këtj Aktvendimi paditësi ka ushtruar ankesë.

Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac.nr.188/23 të datës 25.01.2023, ka refuzuar sit ë pathemeltë ankesën e paditësit, ndërsa Aktvendimin C.nr.674/22 të datës 20.10.2022 e ka vërtetuar.

Paditësi më pastaj parashtron propozim për përsëritje të procedurës me datë 06.03.2023 dhe ka prpoozur që të lejohet përsëritja e procedurës së përfunduar me Aktvendimin Ac.nr.188/23 të datës 25.01.2023 (data e publikimit në smil 31.01.2023).

Gjykata e Apelit me Aktvendimin CN.nr.90/2023 të datës 31.07.2023 ka hedhur sit ë palejuar propozimin për përsëritje të procedurës, me arsyetim se në kuptim të dispozitës së nenit 232.1 dhe 237.7 të LPK-ës, një propozim i tillë është i palejuar. Nuk rastin konkret nk janë plotësuar kushtet për paraqitjen e propozimit, sepse aktvendimi për refuzimin e kërkesës për lirim nga garancioni nuk praqet zgjidhje të çështjes kryesore.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik, për sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesë, e as me shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndërsa nuk qëndrojnë edhe pretendimet tjera të cekura në ankesë. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore-dispozitave të LPK-së dhe të LPP.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është është hartuar në përputhje me dispozitën e nenit 160 të LPK-së, pasi që i njëjti është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike

dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për hedhjen poshtë si të palejuar propozimin e propozuesit për përsëritjen e procedurës, bazuar në nenin 232.1 dhe 237.7 të LPK-ës.

Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat procedurale nga neni 232 i LPK-ës.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të palës ankuese, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5685/2023, datë 11.03.2024

Kryetari i kolegjit, Ardian Ajvazi